

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Projektligji për Byronë i kalon Qeverisë dhe shkon në Kuvend, ekspertët japin vlerësimet e tyre
ADRESA	https://albeu.com/kosove/projektligji-per-byrone-i-kalon-qeverise-dhe-shkon-ne-kuvend-ekspertet-japin-vleresimet-e-tyre/1030438/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:05:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:01:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dc2f2de514cd7c7101571cc891c8682ca12b1fd3f3541e51ac4ae50bc08e89fe
TEKSTI	bceeb1d6347b1eb64164426739583d36dfa3b95b10c64b3a2c559622030bc855
PAMJA	2c168b352529d8c90ba9b1f2cd4ac8bf229f7fba596d34d4dafb7e9b08164aca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	71de859644c61f2d8661ab064cc1a90bfae51d1a0bf4be6b69027ba8d923ee38
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/71de859644c61f2d8661ab064cc1a90bfae51d1a0bf4be6b69027ba8d923ee38>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Projektligji për Byronë i kalon Qeverisë dhe shkon në Kuvend, ekspertët japin vlerësimet e tyre



Të shtunën, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe e përcoloi atë në Kuvend për shqyrtim.

Ekzekutivi bëri të ditur se projektligji synon krijimin dhe organizimin e Byrosë, përcaktimin e kompetencave të saj, si dhe vendosjen e procedurave për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

Në komunikatën e Qeverisë thuhet se është miratuar projektligji që përcakton themelimin, organizimin dhe kompetencat e Byrosë Shtetërore, si dhe procedurën që do të ndiqet për verifikimin e konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

Ministria e Drejtësisë, Donika Gërvalla, tha në një konferencë për media se projektligji vjen pas një procesi të gjatë hartimi e rishikimi, ku janë marrë parasysh vlerësimet e institucioneve përkatese dhe komentet e shoqërisë civile.

"Lajm jashtëzakonisht i mirë është edhe dërgimi në Kuvend i ligjit për Byronë. Që nga mandati i kaluar, ai ka pësuar disa ndryshime të lehta dhe është rikthyer për konsultim publik. Projektligji i proceduar në Kuvend duhet parë si rezultat i një procesi të tërë: është hartuar e rishikuar në disa faza, është vlerësuar nga Komisioni i Venecias, është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese dhe është ndryshuar në bazë të gjetjeve të saj. Më pas është hapur sërish për konsultim publik, ku janë përfshirë në masë të madhe edhe komentet e shoqërisë civile", deklaroi Gërvalla.

Gërvalla sqaroi se Byroja nuk do të vendosë përfundimisht për konfiskimin e pasurisë, pasi këtë kompetencë e ka gjykata.

të fundit /



Projektligji për Byronë i kalon Qeverisë dhe shkon në Kuvend,...



Vllaznia ka dy javë kohë për të vendosur kush do ta pasojë Edi...



Zjarri shkrumoi lokalit në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, banor...



Zjarr shkatërron lokalit në Athinë ku u ekzekutua Pëllumb...



Klopp merr përgjegjësinë pas disfatës 1-0 të...



Trump hedh poshtë ofertën e Iranit për Ngushticën e Hormuz...



LSDM: 11 javë pas helmimit në Gostivar, ende nuk ka raport p...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Ky ligj nuk krijon mekanizëm penal dhe Byroja nuk konfiskon pasuri. Projektligji parasheh një procedurë civile para gjykatës, me standarde të përcaktuara prove dhe të drejtë ankese. Byroja kryen punë përgatitore dhe analitike: mbledh, analizon e verifikon të dhëna dhe, nëse vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore, e paraqet çështjen në gjykatë. Ajo nuk merr vetë vendim për konfiskim. Vendimi përfundimtar për konfiskimin e pasurisë merret ekskluzivisht nga gjykata", tha ministria.

Ekspertët theksojnë se luftimi i korrupsionit është i rëndësishëm, por projektligji duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe të krijojë një mekanizëm që mund të funksionojë në praktikë. Sipas tyre, rezultatet varen nga funksionimi i institucioneve dhe zbatimi konkret i ligjeve.

Halilaj: Kuvendi duhet ta çojë deri në fund procedurën për Byronë e Konfiskimit

Avokati Gazmend Halilaj, në një prononcim për "Bota sot", e vlerësoi procedimin e projektligjit si hap të rëndësishëm. Ai rikujtoi se nisma e ka kaluar tashmë leximin e parë në Kuvend.

"Si jurist, e konsideroj hap të rëndësishëm procedimin në Zyrën e Kryeministrit të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.



Projektligji e ka kaluar tashmë leximin e parë në Kuvend, ndërsa hapat e mëtejshëm duhet të zhvillohen sipas rregullave parlamentare dhe kushtetuese.

Pas procedimit nga Qeveria, teksti kalon në shqyrtimet përkatëse dhe më pas trajtohet në komisionet parlamentare. Aty shqyrtohen amendamentet e mundshme, para se të shkojë për lexim të dytë në seancë plenare", tha Halilaj.

Ai vuri në dukje se përpara se të vazhdohet me fazat e tjera, projektligji duhet të përputhet me standardet kushtetuese.

"Është e rëndësishme që vërejtjet juridike dhe kushtetuese të trajtohen siç duhet. Prandaj, rishikimi dhe harmonizimi i projektligjit me standardet kushtetuese janë të domosdoshme para vijimit të procedurave.

Synimi përmbytësor është krijimi i një mekanizmi institucional që verifikon pasurinë e pajustificueshme dhe e forcon luftën kundër korrupsionit. Byroja nuk është gjykatë dhe nuk vendos përfundimisht për konfiskimin; këtë e bën gjykata, sipas procedurave ligjore", shtoi ai.

Halilaj e cilësoi nismën reformë që kërkon trajtim serioz, duke pasur parasysh se synon më shumë transparencë dhe llogaridhënie për pasurinë e pajustificueshme.

"Kjo reformë meriton vëmendje serioze, sepse synon standarde më të larta të transparencës dhe llogaridhënies lidhur me pasurinë e pajustificueshme.

Përtej debateve politike, rëndësi ka që procesi të përmbyllet në mënyrë kushtetuese e ligjore dhe që mekanizmi i krijuar të jetë funksional në të vërtetë.

Reformat kundër korrupsionit dhe për forcimin e llogaridhënies institucionale duhen mbështetur kur mbështeten në themele të qëndrueshme juridike.

Tash i takon Kuvendit ta përfundojë procedurën dhe të japë verdiktin e tij përfundimtar", deklaroi Halilaj për "Bota sot".

Burjani propozon panel me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë





Blerim Burjani komentoi projektligjin në një bisedë me "Bota sot", duke shprehur shqetësime për mënyrën se si është luftuar deri më tani krimi i organizuar dhe pasuria e krijuar në rrugë të paligjshme.

"Kosova, me këtë infrastrukturë, asnjëherë deri më tash nuk e ka luftuar krimin e organizuar dhe milionerët e krijuar në mënyrë të paligjshme", deklaroi ai.

Burjani tha se një panel i posaçëm gjyqtarësh e prokurorësh, i angazhuar në rastet e korrupsionit, mund të ishte një mënyrë për të arritur rezultate konkrete.

Ai sugjeroi gjithashtu përfshirjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, duke e parë këtë si mundësi për trajtim më efikas të rasteve korruptive.

"Shpresa e vetme që do të mund të jepte rezultat është një panel me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Këtu nuk ka kush të merret me këtë punë, ndaj nuk ka çfarë të komentohet", përfundoi Burjani për "Bota sot".

Shtuar më 28.09.2026 10:01

Tags: [KUVEND](#), [Kuvendi i Kosoves](#), [Qeveria](#)



Kuvendi mbledhet sot, Kurti shfaqet në parlament dy orë para seancës



Ursula von der Leyen viziton Kosovën më 1 tetor



Dosja 23" mund të kthehet në një hap të rëndësishëm kundër...



Pse viktimat e krimeve të luftës mbeten në hije?



Procesi gjyqësor ndaj 21 personave për dëbimin masiv të shqiptarëve nga...



Seancë plenare në Kuvend, në fokus Deklarata për vendimin e Hagës



Kurti: Në SHBA u diskutua për Hagën, të pagjeturit dhe perspektivën euro-...



Zjarri përfshin sërish shtëpinë e Vudi Xhymshitit, gazetari kërkon hetim dh...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.